Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË SË PUNËVE TË BRENDSHME PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

A1 Gjatë vitit 2021, Ministria kishte paguar dhe regjistruar pagesa në vlerë prej 22,974€ nga kategoria ekonomike jo adekuate, si rezultat i vendimeve gjyqësore.

B1 MPB gjatë vitit 2021 kishte realizuar pagesa në vlerë prej 97,099€ për 20 punonjës (të angazhuar me Marrëveshje të Brukselit) të cilët nuk evidentohen për vijueshmërinë në punë dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri.

B2 Vlera e pasurive kapitale e prezantuar në PVF ishte mbivlerësuar për 1,108,902€ si rezultat i mos-bartjes së pronësisë së projektit të përfunduar për komunën.

B3 Detyrimet Kontingjente të shpalosura në nenin 18 të Raportit Vjetor Financiar ishte nënvlerësuar për 2,826,532€.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Punëve të Brendshme kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

B4 Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) kishte bërë pagesa në vlerë prej 53,702€ pa kontratë valide. Pagesat ishin bërë bazuar në vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm për shërbimet-telefonike, mobile, internet, internet për GRPS, kabull Optik, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet TV kablloreve.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Çështje tjetër

1 Kontratat dhe pagesat të cilat Ministria e Punëve të Brendshme i kishte të klasifikuara si dokumente Sekrete nuk janë audituar.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri i MPB-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Ministrisë së Punëve të Brendshme është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Punëve të Brendshme në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Punëve të Brendshme me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Në kontekst të sistemeve financiare, fushat ku janë identifikuar mangësi më të theksuara ishin mbi vlerësimi i regjistrave të pasurisë, pagesa e punonjësve të komunitetit serb në mungesë të evidencave të ardhje-vajtje në punë, nënvlerësimi i detyrimet kontingjente, pastaj mbajtja e pozitave në mospërputhje me gradat e fituara dhe llogaritë e arkëtueshme.

Ky raport ka rezultuar me dhjetë (10) rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja dhe gjashtë (6) të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja

Sipas nenit 18 pikës 3 të rregullës financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.

Gjatë vitit 2021, Thesari përmes vendimit gjyqësorë kishte kryer një pagesë në vlerë 22,974€ nga kategoria ekonomike jo adekuate. Kjo pagesë ishte për kompensimin e pagës për një zyrtar të PK-së të larguar nga puna. Ky shpenzim për nga natyra i takon kategorisë paga dhe mëditje, ndërsa ishte paguar/regjistruar në kategorinë subvencione dhe transfere.

Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ka ndodhur në mungesë të mjeteve buxhetore në kodet adekuate.

Ndikimi

Pagesat e kryera nga kategoria ekonomike jo adekuate ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin të kategorive përkatëse të shpenzimeve. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi A1

Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të sigurojë se shpenzimet planifikohen dhe realizohen konform kategorive ekonomike adekuate, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre sipas standardeve të kontabilitetit të sektorit publik në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet ridestinimi i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B1 - Kompensim i pagave pa vijueshmëri në punë

Gjetja

Neni 8 i Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve", përcakton se -"Gjatë orarit të punës të gjithë zyrtarët publik janë të obliguar të jenë në vendin e punës. Çdo zyrtar publik shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik".

Bazuar në vendimin e Qeverisë Nr.06/39 i dt. 22.07.2015, ish MAP ka qenë e obliguar t'i sistemojë 20 punëtorë të komunitetit serb, pjesëtarë të strukturës ilegale të ashtuquajtur ''Mbrojtja civile''. Sipas konfirmimeve nga zyrtarët e Ministrisë këta të punësuar nuk kanë hapësira të përcaktuara të punës dhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në Ministri. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2021 ishte 97,099€.

Kjo dukuri po vazhdon të jetë prezente ndër vite edhe pse në vazhdimësi po raportohet në raportet tona të auditimit. Ministria ende nuk ka arritur të ndërmerr masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve.

Ndikimi Pagesat e pagave në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë, janë pagesa të parregullta dhe shkaktojnë dëmtim të buxhetit, si dhe mos arritje të objektivave të përcaktuara në marrëveshje dhe mos integrim të këtij komunitetit në sistemin aktual.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar krijimin e kushteve për vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mbi vlerësim i regjistrit të pasurisë

Gjetja Neni 11.3 i rregullores nr. 02/2013 për Menaxhimin e pasurisë jo financiare përcakton se - Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi. Ndërsa sipas nenit 22.2 “Zhvlerësimi llogaritet në baza mujore. Pasuria nuk zhvlerësohet në muajin e blerjes.”

Ministria vazhdon të mbajë në regjistra të pasurisë si pasuri në vijim projektin ‘Ndërtimi i shkollës fillore në Bajqinë – Podujevë’ në vlerë prej 1,108,902€, të bashkëfinancuar i cili kishte përfunduar dhe ishte bërë pranimi teknik nga komisioni përkatës me datë 14.09.2021, duke mbivlerësuar vlerën e pasurive kapitale për këtë vlerë.

Gjatë auditimit kemi identifikuar se vlera e pasurisë jo-kapitale e prezantuar në PFV nuk ishte e plotë për shkak se për pasuritë e blera në vitin 2021 në Agjencionin për Menaxhimin e Emergjencave dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës nuk ishte aplikuar zhvlerësimi i pasurisë.

Mangësitë e identifikuara kishin ardhur si rezultat i mos-funksionimit të kontrolleve të brendshme në këtë fushë si dhe problemeve të vazhdueshme në funksionalitetin e sistemit e-pasuria.

Ndikimi Mbajtja e projekteve të përfunduara në regjistrin e pasurisë si investim në vijim dhe mos-aplikimi i zhvlerësimit të pasurive jo-kapitale ndikon në paraqitje jo të drejtë dhe mbivlerësim të vlerës së pasurisë në PFV.

Rekomandimi B2 Ministri duhet të sigurojë se projektet e financuara për komuna për të cilat janë bërë pranimet teknike dhe i kanë nën administrim këto pasuri, përmes procedurave formale të bëj bartjen e pronësisë dhe në të njëjtën kohë të largoj nga regjistrat e pasurisë së ministrisë. Po ashtu, të sigurojë se aplikohet zhvlerësimi i pasurive jo-kapitale me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Prezantim jo i saktë i detyrimeve kontingjente

Gjetja

Neni 6 i Rregullores MF.nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore parasheh se: "Organizatat buxhetore mbajnë regjistra kontabël të saktë, të plotë, të azhurnuar dhe në harmoni me legjislacionin në fuqi, për të gjitha informatat financiare dhe informatat tjera jo financiare".

Ministria në PVF-të kishte paraqitur detyrimet kontingjente në vlerë prej 8,094,499€. Gjatë auditimit kemi identifikuar që vlera e detyrimeve kontingjente ishte nënvlerësuar për 2,826,532€ (prej tyre 2,588,769€ nuk ishin të prezantuara nga PK-ja).

Kjo ka ndodhur si rezultat i moskordinimit ndërmjet avokaturës shtetërore dhe zyrtarëve përgjegjës të ministrisë.

Ndikimi

Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me vlerën detyrimeve kontingjente.

Rekomandimi B3

Ministri në bashkëpunim me drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të siguroj koordinim me avokaturën shtetërore në mënyrë që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të sakta si dhe mbajtjen e evidencave të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B4 - Pagesa e bërë pas përfundimit të afatit të kontratës

Gjetja

Kontrata për "Shërbimet - telefonike mobile, internet, internet për GPRS, kabulli Optik, shërbimet e telefonisë fikse, shërbimet TV - Kabllovik", neni 1,4 përcakton se kontrata publike kornizë kishte afat prej 36 muajve, duke filluar prej 01.04.2017 e deri me 31.03.2020.

Gjatë procesit të auditimit kemi identifikuar që me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm ishin bërë tri (3) pagesa në vlerë prej 53,702€ për Telekomin e Kosovës për shkak se kishte skaduar kontrata.

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike pas përfundimit të kontratës i kishte propozuar Qeverisë së Republikës së Kosovës që procedura e prokurimit për shërbime të telekomunikimit të përjashtohet nga LPP. Me datën 02.04.2020 Qeveria e Republikës së Kosovës, kishte miratuar propozimin e ministrisë përmes Vendimit nr.05/21, me të cilën kishte përjashtuar nga fushëveprimi i Ligjit të Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, shërbimet e telekomunikimit që ofron Telekomi i Kosovës SH.A, si shërbime me rëndësi të veçantë shtetërore.

Pas përjashtimit të procedurës nga procesi i prokurimit, Drejtori i Agjencionit të Shoqërisë së Informacionit (ASHI)-MPB me datë 08.04.2020 kishte themeluar komisionin ndërinstitucional për negocimin e kushteve të Kontratës për shërbimet telekomunikuese që ofron Telekomi i Kosovës SH.A. të cilat shfrytëzohen nga të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës të nivelit qendror e lokal.

Komisioni me datën 27.05.2020 kishte përgatitur raportin e punës dhe në koordinim me Telekomin e Kosovës kishte hartuar draft-kontratën finale për nënshkrim. Edhe pse komisioni e kishte përfunduar punën, MPB nuk kishte nënshkruar kontratën dhe kishte vazhduar pagesat përmes vendimeve me modul të aprovimit. Ne kemi kërkuar sqarime se pse nuk është bërë nënshkrimi i kontratës për shërbime e telekomunikimit por MPB nuk ka ofruar ndonjë sqarim konkret përveç asaj që është përshkruar më lartë.

Më pas, me ndryshimin e Qeverisë, Kryeministri me 07.10.2020 nxjerr vendim me Nr. 05/34 ku i shfuqizon disa vendime duke përfshirë edhe Vendimin Nr. 05/21 të datës 02.04.2020. Sipas këtij vendimi " Obligohen të gjitha institucionet/ organizatat buxhetore që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Prokurim Publik dhe t'i ndjekin në mënyrë strikte të gjitha procedurat e përcaktuara me Ligj dhe të mos kryejnë procedura të prokurimit sipas nenit 3 të Ligjit për Prokurim Publik pa vendim të Qeverisë".

Kështu që nga data e këtij vendimi ministria nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit për ta zgjidhur këtë situate me të cilën po ballafaqohen shumica e Organizatave Buxhetore.

Ndikimi Mos zgjidhja e kësaj situate të krijuar po ndikon që të pranohen shërbime nga Telekomi i Kosovës pa kontratë dhe të cilat janë duke u paguar nga Organizatat Buxhetore.

Rekomandimi B4 Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në këtë proces duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar zgjidhjen e kësaj situate.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 95,762,153€, prej tyre ishin shpenzuar 95,758,690€. Numri i të punësuarve sipas buxhetit ishte 11,060 punonjës ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 10,600 punonjës. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja B5 - Ushtrimi i pozitave të punës në mospërputhje me gradat e fituara

Gjetja Udhëzimi Administrativ (UA) Nr. 02/2018 për rregullimin e marrëdhënies së punës në Policinë e Kosovës (PK), përkatësisht neni 39 paragrafi 3 përcakton se: me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë secili zyrtar i Policisë mund të caktohet në një vend të punës apo transferohet prej një vendi në vendin tjetër të punës nëse i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për atë vend të punës, pa marrë parasysh nivelin, pozitën apo gradën. Udhëzimi Administrativ nr.02/2019 për procedurën e gradimit për zyrtarët policor përcakton kriteret që duhet t'i plotësoj secili Zyrtar Policor për pjesëmarrje në gradim dhe procesin e testimit që duhet t'i nënshtrohet për të marrë gradën e caktuar. Struktura organizative e Policisë së Kosovës përcakton gradën e kërkuar për secilën pozitë të punës.

Një numër i stafit policor është sistemuar në pozita të punës pa e plotësuar kriterin e gradës që e kërkon ajo pozitë sipas strukturës organizative. Sipas të dhënave nga njësia e personelit, 193 zyrtarë policor vazhdojnë të mbeten të sistemuar në pozita ku kërkohet gradë më e lartë se sa grada që aktualisht e kishin arritur të punësuarit përmes procesit të rregullt të gradimit. Vlen të theksohet se PK, kishte kryer disa procese të gradimit për reduktim të numrit të punësuarve që ushtrojnë pozita me grada më të larta por deri më tani këto procese janë të pamjaftueshme për respektimin e plotë të kritereve të sistematizimit në vendet e punës sipas gradës përkatëse. Pra, në raport me vitin paraprak numri i zyrtarëve është rritur nga 168 në 193.

Ndikimi Sistemimi i stafit në pozita që nuk janë në përputhje me gradën adekuate mund të ndikojë që pozitat e punës të ushtrohen nga persona me mungesë të kompetencës profesionale.

Rekomandimi B5 Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunalitë në vitin 2021 ishte 33,672,966€, prej tyre ishin shpenzuar 31,562,218€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me blerjen e derivateve të naftës, furnizime me material zyrtar, furnizime tjera për nevoja të ministrisë. Gjatë auditimit kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja A2 - Dobësi në menaxhimin e kontratës

Gjetja Sipas kontratës " Shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike (AKSP)",të nënshkruar me datë 18.01.2021 neni 1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me " vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet të dërgoj "porosinë" tek ofertuesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve që duhet të shërbehen me sasitë e tyre përkatëse. Po ashtu, sipas UOPP pika 61.12 përcakton që, në rast të kontratës publike kornizë apo marrëveshjeve me afat të gjatë, atëherë kur është e mundur, Menaxheri i Kontratës do të lëshojë Fletë porosi çdo herë kur shfaqet nevoja.

Gjatë testimit të dy pagesave në vlerë 55,675€ për shërbimet e përgatitjes dhe furnizimit me ushqim për nevojat e AKSP-së, kemi vërejtur që kishte mospërputhje ndërmjet kërkesës (porosisë) së AKSP të bërë përmes e-mail-it për numrin e pjesëmarrësve në shfrytëzimin e racioneve të ushqimit gjatë javës, dhe faturimit përkatësish numrit të atyre që realisht shfrytëzojnë këto racione të ushqimit.

Kjo kishte ndodhur për shkak se AKSP bënë porosinë bazuar në planin e trajnimeve pa konfirmuar nëse të njëjtit do të jenë edhe shfrytëzues të racioneve të ushqimit, përderisa pagesa bazohet në numrin e atyre që evidentohen (klikohen në sistem) me rastin e shfrytëzimit të racioneve.

Ndikimi Kjo shkakton paqartësi sa i përket respektimit të kushteve të kontratës respektivisht nenit 1.2 të kontratës së cekur më lartë lidhur me porosinë dhe rrit rrezikun për padi gjyqësore ndaj institucionit nga operatori.

Rekomandimi A2 Ministri në bashkëpunim me drejtorin e AKSP duhet të sigurojnë se numri i porosive do të bëhet pas konfirmimit të pjesëmarrësve në trajnime, në mënyrë që mospërputhja në mes të kërkesës dhe realizimit të jetë sa më i përafërt.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A3 - Pagesa e qirasë për ish objektin e IPK-së

Gjetja

Neni 39.1 i LMFPP nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagim.

Lidhur me këtë kemi identifikuar se :

Me 08.04.2010 Ministria e Administratës Publike ka nxjerrë vendim për dhënien e objektit të ish NP “Urata” në shfrytëzim të përkohshëm për Inspektoratin e Policisë së Kosovës.

Me 20.12.2010 prona ishte privatizuar, dhe si rrjedhojë e kësaj pronari i ri ka ofruar dy mundësi për IPK-në i cili u menaxhua nga ish MAP-i, që të kontraktohet hapësira prej 865m² dhe toka në sipërfaqe prej 2,520m², për shfrytëzim mujor me çmim prej 22,850€ ose të lirohet brenda 30 ditësh kalendarike.

Edhe pas shkresave të vazhdueshme nga IPK-ja drejtuar ish MAP-it për një zgjidhje sa më të shpejtë për akomodim, ish MAP-i nuk ka ndërmarrë asnjë hap dhe objekti është shfrytëzuar deri me datën 20.05.2013.

Pronari i ri ka bërë ankesë në gjykatë dhe si rrjedhojë e kësaj me datën 03.05.2019 gjykata ka marrë vendim ku i ka dhënë të drejtë ankuesit.

Pagesa është bërë me datën 21.12.2021 në vlerë totale prej 603,463€, prej tyre 557,669€ janë paguar në emër të qirasë, ndërsa pjesa tjetër prej 45,794€ janë kosto shtesë.

Kjo ka ndodhur si pasojë e privatizimit të objektit të ish NP "URATA" dhe mos ndërmarrjes së veprimeve nga ish MAP-i.

Ndikimi

Mos marrja e vendimeve me kohë ndikon që këto pagesa të realizohen përmes vendimeve gjyqësore, e të cilat kanë edhe shpenzime tjera shtesë. Po ashtu, në të njëjtën kohë ndikon edhe në rritjen e shpenzimeve të pa planifikuara.

Rekomandimi A3

Ministri duhet të siguroj që vendimet e tilla të mirën me kohë sipas kërkesave ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 29,116,766€, prej tyre ishin shpenzuar 23,909,746€. Ato kanë të bëjnë me ndërtimin dhe renovimin e objekteve, blerjen e automjeteve, furnizim me licenca për programe, etj.

Çështja A4 - Pranimi i furnizimeve në mungesë të dokumentacionit specifik sipas kontatës

Gjetja

Neni 7.1 i kushteve të veçanta të kontratës thotë që "Furnizuesi së bashku me dorëzimin e mallit të dorëzohet fletëdërgesës t'i bashkëngjitet edhe numrin e DUD-it dhe CMR (fletëdërgesa ndërkombëtare për importin e mallit).

Gjatë auditimit kemi identifikuar një rast ku furnizuesi nuk kishte bashkangjitur DUD-in dhe CMR-n me rastin e liferimit të mallit siç ishte përcaktuar me kontratë. Kjo ka ndodhur tek pagesa për paisje tjera në vlerë prej 8,870€.

Kjo kishte ndodhur në mungesë të kujdesit të duhur nga ana e zyrtarëve përgjegjës të pranimit të furnizimeve.

Ndikimi

Mos ofrimi i dëshmive të kërkuara që dëshmojnë prejardhjen e mallit rrit rrezikun që cilësia e furnizimeve mund të mos jetë në përputhshmëri të plotë me specifikat teknike të kërkuara me kontratë.

Rekomandimi A4

Ministri duhet të sigurojë se pranimi i mallit dhe pagesat do të realizohen vetëm pas ofrimit të dëshmive të kërkuara me kontratë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Të arkëtueshmet

MPB në PFV e vitit 2021 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 25,526,791€. Kjo vlerë përbëhet nga gjobat e trafikut, gjobat për COVID-19 dhe nga punët sekondare që ofrohen nga Policia e Kosovës në ofrimin e shërbimeve të sigurimit për objekte publike.

Çështja B6 - Mangësi në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Ne kemi identifikuar se në katër (4) raste Policia e Kosovës në pajtim me ligjet në fuqi kishte lëshuar fletëparaqitje për kundërvajtje duke i proceduar lëndët në Gjykatë. Për këto 4 raste sistemi informativ i policisë kishte përllogaritur vlerën financiare në shumë 3,650€, të cilat ishin të raportuara edhe në PVF. Këto gjoba nuk është dashur të raportohen në PVF si llogari të arkëtueshme pasi kanë kaluar nën menaxhimin e gjykatave. Sipas zyrtarëve shkaku i ndodhjes së kësaj dukurie është se në momentin e lëshimit të tiketës nga policia për gjykatë sistemi në mënyrë automatike e

llogaritë shumën financiare.

Në një rast kemi vërejtur se fatura në vlerë 8,370€ është lëshuar më 18.03.2022 dhe është raportuar si llogari e arkëtueshme në PVF-të e vitit 2021. Kjo lëndë i referohet sigurimit për mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike në ndeshjet futbollistike të cilin e kryen PK për Federatën e Futbollit të Kosovës e cila i përket muajit tetor 2021.

Kjo ka ardhur si pasojë e futjes së gabueshme të informatave në sistemin elektronik si dhe mungesës së vëmendjes nga personat përgjegjës për regjistrim dhe raportim të shpalosjeve.

Ndikimi

Regjistrimi në sistem i fletëparaqitjeve të cilat kanë kaluar në gjykata si dhe gabimet e bëra në regjistrimin e llogarive të arkëtueshme kanë ndikuar në prezantim jo të saktë të LL/A në PVF.

Rekomandimi B6

Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe të forcoj kontrollet në raportimin e LL/A për të siguruar prezantim të saktë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[4]	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**142,286,900**	**160,197,619**	**152,641,683**	**150,311,343**	**128,689,456**
Grante Qeveritare – Buxheti	141,395,771	159,046,907	151,744,330	145,784,719	118,951,966
Të bartura nga viti i kaluar	0	236,273	230,011	23,531	0
Të hyrat vetanake	891,129	891,129	663,482	654,856	550,380
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	3,830,748	9,185,323
Donacionet e jashtme	0	23,310	3,860	17,490	1,788

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 17,910,719€. Kjo rritje është rezultat i rishikimit buxhetor dhe vendimeve të qeverisë.

Në vitin 2021 MPB ka shpenzuar 95% të buxhetit përfundimtar ose 152,641,683€, me një përmirësim prej 2% në krahasim me vitin 2020.

Sidoqoftë, shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**142,286,900**	**160,197,619**	**152,641,683**	**150,311,343**	**128,689,456**
Pagat dhe mëditjet	76,727,162	95,762,153	95,758,690	103,865,391	85,542,782
Mallrat dhe shërbimet	28,828,968	29,310,610	27,315,575	23,725,758	23,456,350
Komunalitë	4,950,400	4,362,356	4,246,643	3,609,444	1,308,441
Subvencionet dhe transferet	2,141,367	1,645,734	1,411,029	1,276,828	950,627
Investimet Kapitale	29,639,004	29,116,766	23,909,746	17,833,923	17,431,257

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

• Buxheti final për paga dhe mëditje në krahasim me buxhetin fillestar, ishte rritur për 19,034,991€, si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë, për mbulimin e deficitit të buxhetit për paga si dhe pagesat e punës jashtë orarit për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19 . Realizimi i buxhetit final ishte 100%.

• Buxheti final për mallra dhe shërbime në krahasim me buxhetin fillestar, kishte rritje për 481,642€, si rezultat i rishikimit të buxhetit, ndërsa kishte rritje dhe zvogëlim sipas vendimeve të qeverisë, si dhe transferit të brendshëm. Realizimi i buxhetit final ishte 93%.


• Buxheti final i shërbimeve komunale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 588,044€ si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të qeverisë. Realizimi i buxhetit final ishte 97%.

• Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte zvogëluar për 495,633€, si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final ishte 86%.

• Buxheti final për investime kapitale në krahasim me buxhetin fillestar, ishte zvogëluar për 522,238€, si rezultat i rishikimit të buxhetit dhe vendimeve të Qeverisë. Realizimi i buxhetit final ishte 82%.

• Shpenzimet e ndodhura për menaxhimin e pandemisë COVID 19 nga ministria ishin në vlerë totale prej 3,396,323€. Prej tyre 3,395,464€ ishin shpenzuar në paga ndërsa 859€ në kategorinë mallra dhe shërbime.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga MPB në 2021 ishin në vlerë 66,589,545€. Të hyrat e realizuara rrjedhin nga taksat për regjistrimin e automjeteve, taksat rrugore, taksa për dokumente të udhëtimit, gjoba në trafik dhe taksa tjera.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	**60,778,922**	**60,959,083**	**66,589,545**	**52,209,533**	**62,209,192**
Të hyrat jo tatimore	60,778,922	60,959,083	66,586,560	52,209,533	62,209,192
Të hyrat tjera	0	0	2,985		

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të MPB-së ka rezultuar në 16 rekomandime. MPB kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, nëntë (9) rekomandime janë zbatuar, gjashtë (6) nuk janë adresuar ende dhe një(1) nuk është i aplikueshëm më, siç është paraqitur në Grafikun 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë që regjistri i pasurisë të azhurnohet në vazhdimësi në raport me projektet e përfunduara duke i respektuar të gjitha rregullat dhe procedurat e kërkuara me rregulloren e aplikueshme të pasurisë.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar pa rregullsi të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
2.	Baza për opinion	Ministri në bashkëpunim me drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të siguroj që detyrimet kontingjente të prezantohen në shuma të sakta si dhe të mbajë evidenca të plota lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Gjatë vitit 2021 kemi vërejtur se ende ka probleme të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim i pa zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi
3.	Baza për opinion	Ministri duhet të merr masa që në koordinim me akterët përgjegjës të zgjidhen problemet me sistemin E-pasuria në mënyrë që gjendja e pasurisë	Gjatë vitit 2021 ishin rregulluar këto pasuri në regjistrin e	I zbatuar

		jo-kapitale të entitetit të prezantohet saktë.	pasurisë, ndërsa sa i përket zhvlerësimit të pasurisë jo kapitale gjetja është fuzionuar tek Çështja B2.	
4.	Baza për opinion	Ministri dhe Drejtori i AME-së duhet të marrin masa për të siguruar kthimin e mjeteve të paguara për stafin që nuk janë zjarrfikës dhe të sigurojë që mos të ndodhin në të ardhmen pagesa që nuk janë në pajtim me legjislacionin në fuqi.	Ministria kishte ndërmarrë masa duke ndaluar që kompensime të tilla të ndodhin gjatë vitit 2021, ndërsa sa i përket kthimit të mjeteve lënda është dërguar në hetuesi.	I zbatuar
5.	Baza për opinion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së dhe Drejtorin e Policisë së Kosovës duhet të sigurojnë që regjistri i pasurive të azhurnohet dhe objektet të cilat nuk janë të regjistruara të regjistrohen sipas kërkesave të rregullores në mënyrë që vlera e pasurive në PFV të jetë e plotë.	Gjatë vitit 2021 janë regjistruar këto pasuri.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Ministri duhet që të shqyrtoj arsyet e mos vijimit në punë të këtyre punëtorëve, të zgjidhë problemin e angazhimit të tyre të rregullt në punë, ose në të kundërtën, të ndërpres pagesat e pagave të tyre të parregullta. Për shkak të kompleksitetit të këtij problemi, ministri rekomandohet çështjen e mëtejme të këtyre pagesave ta adresoj edhe në Qeveri.	Edhe këtë vit kemi të njëjtën çështje.	Nuk ka filluar zbatimi
7.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në këtë proces duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për të siguruar zgjidhjen e kësaj situate.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar mangësitë e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë që mos të bëhen tejkalime të kontratave mbi normën e lejuar 30% dhe kontratat të cilat tashmë kanë tejkaluar limitet e lejuara të ndërpriten menjëherë.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
9.	Baza për konkluzion	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e AKSP-së të siguroj që në pajtim me kërkesat ligjore të përcaktohen afatet kohore të kontratave si dhe kontratat publike kornizë të mos tejkalohen.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
10.	Baza për konkluzion	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të ndërmarrin masa në kthimin e mjeteve për kompensime të pa rregullta dhe të sigurojë që në të ardhmen kompensimet e Sekretarisë së Bordit të AKSP-së të bëhen vetëm mbi bazën e legjislacionit në fuqi.	Ministria kishte ndërmarr masa duke ndaluar që kompensime të tilla të ndodhin gjatë vitit 2021, ndërsa sa i përket kthimit të	I zbatuar

			mjeteve lënda është dërguar në hetuesi.	
11.	Baza për konkluzion	Ministri, respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të rishikojnë vendimin për shujta ditore dhe të ndërmarrin masa për ndalimin e tyre nga kategoria mallra dhe shërbime.	Ministria kishte ndërmarr masa duke ndaluar shujtat për stafin e saj.	I zbatuar
12.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që të ketë ndarje adekuate të detyrave në rastet e emërimit të menaxherëve të kontratës në mënyrë që të parandalohet konflikti i interesit.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
13.	Pagat dhe mëditjet	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i PK-së duhet të sigurojnë që sistemimi i stafit policor në pozita të bëhet pas plotësimit të gradave dhe kushteve për vendin e caktuar të punës dhe që procesi i gradimit është duke u zhvilluar për t'ju përgjigjur nevojave të PK-së.	Edhe në vitin 2021 janë identifikuar mangësitë e njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
14.	Mallrat dhe shërbimet pa Komunalitë	Ministri dhe Drejtori i Përgjithshëm i AKSP-së duhet të sigurojnë përmbushjen e kërkesave ligjore në raport me KRPP-në duke e njoftuar atë në të gjitha rastet kur kjo kërkesë është obligative.	Nuk kemi identifikuar çështje të ngjashme.	I zbatuar
15.	Investimet kapitale	Ministri duhet të ndërmerr masa konkrete përmes të cilave siguron realizimin e projektit për Spitalin e Prishtinës.	Kontrata për hartimin e projektit ka skaduar prandaj ky rekomandim nuk është i aplikueshëm më.	Nuk është i aplikueshëm më
16.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të PK-së duhet të siguroj se fletëparaqitjet për kundërvajtje të cilat kalojnë në gjykata mos të përfshihen në llogaritë e arkëtueshme si dhe me rastin e regjistrimit të gjobave në sistem të paraqiten vlerat e sakta të gjobave në mënyrë që LI/A të prezantohen drejtë në RVF.	Gjatë vitit 2021 kemi vërejtur se ende ka probleme të natyrës së tillë dhe e konsiderojmë si rekomandim të pa zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme




Emine Fazliu, Ndihmëse e Auditorit të Përgjithshëm



Arian Haxha, Drejtor i Auditimit



Shqiponja Krasniqi, Udhëheqëse e ekipit



Mimoza Morina, Anëtare e ekipit



Egzona Maqedonci, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme /Ministarstvo Unutrasnji Poslova
Ministry of Internal Affairs

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2021 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të **Ministrisë së Punëve të Brendshme** për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Xhelal Sveçla
Ministër i Ministrisë se Punëve të Brendshme

Data: 24 qershor 2022, Prishtinë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[5] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[6], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim(e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet – pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[5] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[6] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.